



Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE

Kontributi i EC-it për Raportin e KE-së për Kosovën
Zhvillimi i Qëndrueshëm dhe Sfidat e Planifikimit dhe Ndërtimit në Kosovë
Nëntor 2018, Prizren

PËRMBAJTJA

I. Hyrje	2
II. Përbushja e MSA-së në fushën e mjedisit	3
III. Eurokodet dhe Kodi i Ndërtimit të Kosovës	3
IV. Zbatimi i legjislacionit në sektorët e planifikimit dhe të ndërtimeve gjatë vitit 2018	4
V. Trashëgimia kulturore vuan mosunifikimin e veprimeve të institucioneve	9
VI. Statistikat e organeve të sistemit të drejtësisë për ndërtimet pa leje dhe shkatërrimin e Trashëgimisë Kulturore në Prizren	10
VII. Sfidat për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore në Kosovë.....	11
VIII. Rekomandimet	11

I. Hyrje

Me Zhvillim të Qëndrueshëm përkufizohet zhvillimi që i plotëson nevojat e të tashmes pa e komprometuar mundësinë e brezave të ardhshëm për plotësimin e nevojave të tyre.¹ Koncepti i Zhvillimit të Qëndrueshëm ka lindur si nevojë për një udhërrëfyes të zhvillimit global afatgjatë dhe mbështetet në 3 shtylla kryesore: Zhvillimin Social, Zhvillimin Ekonomik dhe Mbrojtjen e Mjedisit.

Në këtë linjë, më 25 shtator 2015, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, së bashku me 17 Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ) dhe 169 targetet specifike.

Adoptimi i Agjendës 2030 kishte për synim ndryshimin e modelit të politikave globale për rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar drejtë zhvillimit. Bashkimi Evropian (BE) është i përkushtuar në implementimin e OZHQ-ve, si në politikat e brendshme ashtu edhe në politikat e jashtme të saj.

Në Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, Objektivi 11 synon që t'i bëjë qytetet dhe vendbanimet humane gjithëpërfshirëse, të sigurta, rezistuese dhe të qëndrueshme.

Politikat zhvillimore urbane të BE-së specifikisht fokusohen në mbështetjen e vendeve në zhvillim në fushën e mobilitetit urban, sistemet

infrastrukturore, banimit të përbalueshëm dhe efikasitetit të energjisë.

BE promovon zhvillimin e qëndrueshëm urban si një ndër shtyllat kryesore të funksionimit efektiv të qeverisjes lokale.

Në Konferencën e Kombeve të Bashkuara mbi Strehimin dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban (Habitati III), me datën 20 tetor 2016, në Kuito, Ekuador është miratuar Axhenda e re Urbane. Zbatimi i Axhendës së Re Urbane kontribuon për zbatimin e Axhendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, në mënyrë të integruar, si dhe për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, (OZHQ), duke përfshirë Objektivin 11 për t'i bërë qytetet dhe vendbanimet humane gjithëpërfshirëse, të sigurta, rezistuese dhe të qëndrueshme.

Zhvillimi i qëndrueshëm përbën njërin prej angazhimeve të Bashkimit Evropian dhe për këtë arsye normat ligjore, politikat publike dhe praktikat zbatuese vazhdimisht promovojnë qëllimet për zhvillim të mençur, të qëndrueshëm dhe përfshirës.

Kosova në legjislacionin e saj ka përqafuar normat e promovuara nga BE-ja, megjithatë në aspektin e zbatimit të praktikave të mira të planifikimit, ndërtimeve dhe mjedisit çalon ende, duke sfiduar madje edhe parimet bazë të zhvillimit të qëndrueshëm dhe përfshirës. Kësisoj ndërtimet në zona të caktuara në vend të ofrimit të kushteve më të mira për jetesë kanë shtuar problemet, të cilat do ta shoqërojnë komunitetin edhe për një kohë të gjatë.

¹ Komisioni Botëror mbi Ambientin dhe Zhvillimin (World Commission on Environment and Development), 1987, linku: <http://www.un-documents.net/our-common-future.pdf>, qasur me 22 shtator 2018

II. Përmbushja e MSA-së në fushën e mjedisit

Përafrimi i legjislacionit të Kosovës me atë të BE-së, në fushën e Mjedisit, ka dinamikë të transpozimit në nivel mesatar. Janë transpozuar plotësisht, direktivat mbi: Vlerësimin Strategjik Mjedisor; Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Pjesëmarrjen e Publikut. Është në transpozim e sipër, direktiva mbi Themelimin e Infrastrukturës për Informim Hapësinor. Janë në fazat e hershme, zbatimi i direktivave mbi Përgjegjësinë e Mjedisit dhe Krimin Mjedisor.²

Nga nënshkrimi i MSA-së, Qeveria e Kosovës për çdo vit përgatit Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, sipas kapitujve dhe MMPH e përgatit pjesën për Kapitullin 27, Mjedisin. Për këtë vit, sipas MMPH-së për zbatim të Kapitullit 27 Mjedisit të MSA-së janë planifikuar 21 masa nga të cilat 47.62% apo 10 janë masa legjislative (6 ligje, 4 të MMPH dhe 2 të MBPZHR dhe 3 UA) dhe 52.38% apo 11 janë masa zbatuese (1 masë e MBZHR). Sipas raportimit të MMPH mbi përmbushjen e PKZMSA për tremujorin e 3-të të vitit 2018, rezulton se deri në këtë periudhë MMPH-ja ka përmbushur mbi 60% të masave të planifikuara.³

III. Eurokodet dhe Kodi i Ndërtimit të Kosovës

Spektori i ndërtimeve në Europë ka një rëndësi strategjike për shtetet anëtare, ngase ofron ndërtesa dhe infrastrukturë që janë të

² Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2018–2022, linku: http://www.mei-ks.net/repository/docs/20180731115427_1_pkzmsa_2018-2022_final_miratuar nga_kuvendi.pdf, qasur me 10 tetor 2018

³ Përgjigje përmes emailit nga Bajram Kadriu, Zyrtar i lartë për Komunikim, MMPH, 13 nëntor 2018

nevojshme për ekonominë dhe shoqërinë. Zinxhiri i vlerave në ndërtimtari përfshin një gamë të gjerë të aktiviteteve ekonomike, nga nxjerrja e lëndës së parë, prodhimi i produkteve të ndërtimtarisë, deri te dizajnimi, ndërtimi, menaxhimi dhe kontrolli i punëve ndërtimore, mirëmbajtja e tyre, renovimi, demolimi sikurse edhe riciklimi i mbetjeve inerte të ndërtimit. Si i tillë, sektori i ndërtimeve luan rol të rëndësishëm në qëllimet e BE-së për zhvillim të mençur, qëndrueshëm dhe përfshirës, dhe ka ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e jetesës. Politikat e BE-së për ndërtesat synojnë një qasje të integruar, që mbulon qëndrueshmërinë, në aspektin e energjisë dhe efikasitetit të resurseve, çështjet e shëndetit dhe sigurisë.⁴

Siguria e ndërtesave dhe punëve në ndërtimtari është me rëndësi të madhe. Eurokodet luajnë një rol të rëndësishëm në këtë drejtim. Ato janë një sërë standardesh evropiane që sigurojnë një qasje të përbashkët për projektimin strukturor të ndërtesave dhe punëve të tjera të ndërtimtarisë dhe janë referenca e preferuar për specifikimet teknike në kontratat publike. Standardet evropiane sigurojnë mjetet për vlerësimin dhe raportimin e performancës së ndërtesave në lidhje me qëndrueshmërinë sociale, ekonomike dhe mjedisore, duke mbuluar tërë ciklin e jetës. Ato përdoren në të gjithë BE-në dhe promovohen ndërkombëtarisht për të vendosur tregues dhe metoda të harmonizuara në skemat e ndryshme të certifikimit.⁵

⁴ “The European construction sector”, Brochure 2016, European Commission, Internal Market, Industry, Entrepreneurship and SMEs Directorate General, Energy Directorate General, Joint Research Centre (JRC), qasur me 1 shtator 2018

⁵ Po aty

Ligji për Ndërtim i Kosovës ka hyrë në fuqi në vitin 2012.⁶ Në këtë ligj, në nenin 6, parashihet përpilimi i Kodit Unik të Ndërtimit të Kosovës, në frymën e standardeve teknike të BE-së, praktikave më të mira ndërkombëtare dhe rrethanave ekzistuese në Kosovë. Tutje theksohet se qëllimi i Kodit është vendosja e kërkesave minimale për mbrojtjen e shëndetit publik, sigurisë dhe mirëqenies së përgjithshme përmes rezistencës së nevojshme të strukturës së hapësirave të emergjencës, ekuilibrit dhe stabilitetit, sanitarisë, menaxhimit të mbeturinave ndërtimore, ndriçimit adekuat dhe ventilimit, masave për eficiencë dhe kursim të energjisë, dhe sigurisë së jetës dhe pronës nga zjarri dhe rreziqeve tjera që i atribuohen mjedisit ndërtimor si dhe t'i krijoj siguri zjarifikësve dhe përgjegjësve tjerë në raste të emergjencave.

Por zyrtarët e MMPH-së kanë pranuar se Kodi Unik i Ndërtimit akoma nuk është aprovuar. Megjithatë kanë pohuar se pjesë kryesore të Kodit Unik të Ndërtimit do të jenë Eurokodet, së bashku me shtojcat kombëtare, dhe si i tillë mund të jetë i kompletuar për miratim dhe zbatim.⁷

IV. Zbatimi i legjislacionit në sektorët e planifikimit dhe të ndërtimeve gjatë vitit 2018

Kosova ndonëse aplikon përafrimin e legjislacionit të saj me atë të BE-së, megjithatë

⁶ Ligji Nr. 04/L-110 për Ndërtim, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2833>

⁷ Përgjigje përmes emailit nga Bajram Kadriu, Zyrtar i lartë për Komunikim, MMPH, 13 nëntor 2018

duhet ti shtojë përpjekjet për aplikimin e standardeve të planifikimit dhe të ndërtimit sikurse që praktikohen në shtetet anëtare të BE-së.

a) Ndërtimet pa leje

Ligji (i skaduar) për trajtimin e ndërtimeve pa leje (nr. 04/L-188), ka qenë në fuqi nga shkurti i vitit 2014 deri në shkurt të vitit 2017, ku gjatë zbatimit të tij janë evidentuar mbi 352 mijë ndërtime pa leje, që janë përfshirë në regjistrin kombëtar dhe se vetëm afër 8 mijë e 500 aplikime janë bërë për legalizim.

Problemet që janë shfaqur gjatë zbatimit të këtij ligji (nr.04/L-188), synohen të adresohen me Ligjin e ri (Nr. 06/L-024) për trajtimin e ndërtimeve pa leje, që ka hyrë në fuqi në fund të muajit gusht të këtij viti.

Sipas MMPH-së, objektivi i këtij ligji është përmirësimi i procesit të legalizimit përmes rritjes së efektivitetit të procesit të legalizimit duke zvogëluar numrin e dokumenteve të kërkuara gjatë aplikimit për legalizim dhe uljes së kostos për aplikim.

Në mesin e komunitetit profesionist të Kosovës ka mendime se Projektligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje ka defekte serioze. Madje sipas tyre ka nene të caktuara që janë tërësisht të papranueshme.

Si çështje problematike në ligjin e ri shfaqet dispozita që ka të bëjë me “Listën e Pritjes”.

Ligji Nr. 04/L-188 PËR TRAJTIMIN E NDËRTIMEVE PA LEJE, në nenin 12 përkufizonte se aplikimet për Leje për legalizim do të refuzohen, pas inspektimit, nëse organi kompetent gjen se: është i ndërtuar në pronë publike, përkatësisht në zonë me interes publik, në përputhje me ligjet në fuqi; është i ndërtuar

në zonën e mbrojtur të natyrës dhe parqeve kombëtare; është i ndërtuar në korridoret e infrastrukturës në fushën e energjetikës, transportit dhe hidrosistemit; është i ndërtuar në zonat e mbrojtura dhe zonat e veçanta të trashëgimisë kulturore.

Ndërkohë të Ligji (Nr. 06/L-024) I RI PËR TRAJTIMIN E NDËRTIMEVE PA LEJE, neni 10 parasheh që në listën e pritjes të përfshihen ndërtimet pa leje të ndërtuara në: pronë publike; pronë shoqërore; toka bujqësore nën komasacion dhe nën sistem të ujitjes; sipërfaqet e mbrojtura, zonat e mbrojtura, zonat e veçanta të mbrojtura dhe zonat e veçanta, përfshirë parqet kombëtare; dhe korridoret infrastrukture, dhe se përfshirja në listën e pritjes e një ndërtimi nuk e paragjykon vendimin përfundimtar për trajtimin e atij ndërtimi sipas këtij Ligji.

Përmbajtja e Ligjit të ri për trajtimin e ndërtimeve pa leje krijon përshtypjen se i tëri i është përshtatur nevojave të Strategjisë Kombëtare për të drejtat pronësore në Kosovë (shtator 2016). Por krahas Strategjisë Kombëtare për të drejtat pronësore në Kosovë, Qeveria ka të miratuar edhe Strategjinë Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2017-2027, me të cilën trashëgimia kulturore përcaktohet si shtyllë e rëndësishme e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit. Në këtë linjë, ligji i ri për trajtimin e ndërtimeve pa leje duket se nuk e ka konsultuar këtë strategji në masën sa e ka konsultuar atë për të drejtat pronësore në Kosovë.

b) Kosova pa Harta Zonale

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) si autoritet qendror mbetet që të zbatojë legjislacionin që rregullon planifikimin hapësinor. Kjo ministri në prill të vitit 2018 ka

iniciuar hartimin e Hartës Zonale të Kosovës, dokument ky që i mungon planifikimit të nivelit qendror.⁸ Sipas zyrtarëve të MMPH-së, përpilimi i Hartës Zonale të Kosovës parashihet të përmbyllet brenda dy vitesh. Paralelisht me krijimin e Hartës Zonale të Kosovës në proces janë edhe krijimi i Hartave Zonale të Komunave (në 22 komuna)⁹, për të cilat sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor (LPH) përgjegjëse janë komunat, ani pse sipas këtij ligji hartimi i Hartës Zonale të Komunës duhet të bazohet në Hartën Zonale të Kosovës, Planin Zhvillimor Komunal dhe Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.¹⁰

Dispozitat e LPH-së kërkojnë nga komunat “inkurajimin dhe sigurimin e pjesëmarrjes publike në procesin e hartimit dhe të zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor”¹¹. Drejtuesit e Komunës së Prizrenit në shtator kanë pranuar publikisht se procesi i krijimit të Hartës Zonale të Komunës është karakterizuar me numër të vogël të takimeve me publikun.¹²

⁸ “Kosova me Hartë Zonale, Pjesë e Saj edhe Veriu”, kallxo.com, linku: <https://kallxo.com/kosova-me-harte-zonale-pjese-e-saj-edhe-veriu/>, qasur me 3 shtator 2018

⁹ Po aty

¹⁰ Ligji për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174, neni 16, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8865>, qasur me 2 shtator 2018

¹¹ Ligji për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174, neni 11, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8865>, qasur me 2 shtator 2018

¹² “Drejtuesit e Prizrenit të pakënaqur me dinamikën e përpilimit të Hartës Zonale”, Koha.net, linku: <https://www.koha.net/kosove/117621/drejtuesit-e-prizrenit-te-pakenaqur-me-dinamiken-e-perpilimit-te-hartes-zonale/>, qasur me 17 shtator 2018.

Por takimet me publikun për hartimin e Hartës Zonale në Prizren janë intensifikuar prej fundit të muajit tetor.

c) Planet e tejkaluara dhe të pazbatuara

Zyrtarët e Komunës së Prizrenit njëkohësisht kanë deklaruar se Plani gjeneral urbanistik i Prizrenit është i tejkaluar dhe se nuk përputhet me realitetin në terren. Sipas tyre ky plan shumë pak është implementuar, ngase aty ku janë paraparë rrugët janë bërë ndërtesa dhe se aty ku janë paraparë banesa janë bërë ndërtime industriale, etj. Mirëpo monitorimi i EC-it tregon se as Plani Zhvillimor Komunal i Prizrenit që është në fuqi, nuk është zbatuar në përqindje të lartë nga Komuna dhe i njëjti ka nevojë që të revidohet.

d) Përfshirja e ultë e qytetarëve në planifikim dhe vendimmarrje

Parimet për transparencën dhe llogaridhënien e autoriteteve publike si dhe ai i detyrimit të tyre për përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje dhe planifikim janë të normuara në legjislacionin e Republikës së Kosovës duke marrë parasysh edhe standardet e BE-së dhe praktikat e mira ndërkombëtare. Mirëpo në praktikë, ende ka probleme të theksuara me zbatimin e këtij legjislacioni, gjë që rezulton në transparencë të ulët të Komunave dhe të organeve të Qeverisë së Kosovës, e që pastaj po përkthehet në painformim dhe pjesëmarrje të ultë të qytetarëve në dëgjime publike për politikën e ndryshme të qeverisjes lokale dhe asaj qendrore, veçanërisht në sferën e planifikimit dhe të ndërtimeve.

Një sfidë e theksuar në këtë drejtim janë planet për ndërtimin e mini-hidrocentraleve në rajonin e Prizrenit, që kanë ngjallur reagimin e qytetarëve të Luginës së Lumëbardhit (Zhupë),

zonë kjo e banuar kryesisht me pjesëtarët e komunitetit boshnjak, përfaqësuesit e të cilëve shqetësimet në këtë drejtim i kanë paraqitur edhe para udhëheqësve të Qeverisë së Kosovës.¹³ Brenga të ngjashme nga komuniteti janë adresuar edhe në trevën e Gorës, nga pjesëtarët e komunitetit goran. Qytetarët e këtyre zonave kanë shprehur qëndrimin se nuk kanë njohuri për këto plane dhe se institucionet nuk i kanë përfshirë ata në procesin e konsultimeve publike. Këto plane, që mbeten jo-transparente për publikun, njëkohësisht duhet të sigurojnë edhe respektimin e obligimeve për mbrojtjen e natyrës.

Njëkohësisht autoritetet komunale të Prizrenit në këtë mandat kanë shprehur kundërshtimin për ndërtimin e mini-hidrocentraleve në zonën e Luginës së Lumëbardhit. Madje kanë theksuar se me kryetarët e fshatrave janë dakorduar për ndalimin e disa proceseve të dëmshme për këtë anë, sikurse që është ndërtimi i hidrocentraleve, pasi sipas tyre ato do ta shkatërronin mjedisin në këtë trevë, derisa edhe komuniteti është kundër.¹⁴ Në mes të muajit nëntor, autoritetet komunale të Prizrenit, pas bisedave me përfaqësuesit e komunitetit kanë bërë publik

¹³ Haradinaj: Spreman sam pomoći u formiranju bošnjačkih opština, artikull në Info-ks, linku: <http://www.info-ks.net/bosnjaci/aktualno/93409/haradinaj-spreman-sam-pomoci-u-formiranju-bosnjackih-opstina>, qasur me 17 shtator 2018.

¹⁴ Diskutim i kryetarit të Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka në debatin publik: “Përfshirja e parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm brenda komuniteteve në Kosovë”, organizuar nga Komuna e Prizrenit, [Balkan Green Foundation](#) dhe [Kosid](#), me 12 shtator 2018.

qëndrimin se nuk do të lëshojnë leje ndërtimore për mini-hidrocentralet në Zhupë.¹⁵

e) Shkeljet ligjore që kanë të bëjnë me lejet ndërtimore

Mini-hidrocentralet nuk janë shqetësimi i vetëm i shprehur nga autoritetet komunale të Prizrenit mbi defektet e trashëguara nga qeverisjet e kaluara në planifikim dhe ndërtim.

Në prill të këtij viti, drejtuesit e Komunës së Prizrenit kanë identifikuar 34 raste të dyshimta të shkeljeve ligjore që kanë të bëjnë me lejet ndërtimore, tejkalimin e lejeve si dhe ndërtimeve pa leje dhe këto raste i janë dorëzuar prokurorisë për inicimin e hetimeve për keqpërdorimet eventuale. Sipas tyre dyshimet janë se ka pas shkelje të dispozitave të Ligjit për ujërat, pastaj Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, Ligjit për Trashëgiminë Kulturore, Ligjit për Hekurudhat.¹⁶ Ky numër i rasteve sipas informatave të fundit ka shkuar në 40 sosh.

Sipas autoriteteve lokale, Komuna e Prizrenit për më shumë se gjashtë muaj nuk ka mundur të lëshojë leje ndërtimore, si pasojë e vendimit gjyqësor për pezullimin e zbatimit të PZHK-së, PPU-së dhe 2 PRRU-ve, që ndërlikojnë pretendimet për uzurpimin e pronave të Hekurudhës, gjegjësisht ndërtim në brezin e saj pa bazë ligjore. Për hartimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor, ish-qeverisjet në Prizren

¹⁵ Postim në FB, i kryetarit të Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, linku: <https://web.facebook.com/mhaskukaa/photos/a.276065886198262/560035537801294/?type=3&theater>, qasur me 17 nëntor 2018.

¹⁶ Deklaratë e kryetarit të Komunës së Prizrenit gjatë konferencës për media të mbajtur me 10 prill 2018 në Komunën e Prizrenit.

nuk e kanë përfshirë në proces fare "Infrakos"-in.

Për ta zhbllokuar këtë vendim gjyqësor, Komuna është detyruar të bëjë marrëveshje me ndërmarrjen "Infrakos", e cila i menaxhon hekurudhat, duke u obliguar që së bashku me ekipin e tyre në terren të bëjë lirimin e trasesë së hekurudhës. Në shtator 2018 ka filluar aksioni i Inspektoratit në këtë zonë për lirimin nga uzurpimet në rastet ku ka ndërtim në pronën e Hekurudhës. Ndërsa sa i përket ndërtimeve të larta, shumica prej tyre janë bërë jashtë pronës së "Infrakos-it" dhe Komuna ka theksuar se nuk do të bëhen ndërhyrje në to, por ka theksuar se për këto ndërtim qeverisja e kaluar ka lëshuar leje në kundërshtim me Ligjin për Hekurudhat, pasi me legjisllacion parashihet që vija ndërtimore duhet të jetë në 25 metra distancë nga aksi i hekurudhës.

Sipas kryetarit Haskuka, disa ish drejtorë të ekzekutivit të kaluar dhe zyrtarë të tjerë të Komunës së Prizrenit, janë duke u hetuar nga Prokuroria Themelore në Prizren me dyshimin për keqpërdorim të detyrës zyrtare në lidhje me këtë çështje.¹⁷

Në muajin korrik Prokuroria Themelore e Prizrenit pat bërë të ditur se ka ngritur 18 aktakuza ndaj personave që dyshohen për uzurpimin e pronës së Hekurudhave të Kosovës në këtë qytet. Ky organ i akuzës pat theksuar se është duke punuar edhe në 31 raste tjera të kësaj natyre. Drejtuesit e Prokurorisë në Prizren patën pohuar se krahas rasteve të uzurpimeve, po hetohen edhe zyrtarët e institucioneve

¹⁷ Postim në FB, i kryetarit të Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, linku: <https://web.facebook.com/mhaskukaa/photos/a.278298095975041/529319354206246/?type=3&theater>, qasur me 11 tetor 2018

publike që kanë lejuar ndërtime pa leje apo që kanë dhënë leje ndërtimi në këtë zonë në kundërshtim me legjislacionin.

f) Përzierja e kompetencave të nivelit qendror dhe lokal

Në fund të muajit gusht, autoritetet komunale të Prizrenit disa vendime të Zyrës Ligjore të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, i kanë cilësuar si të njëanshme dhe në mbrojtje të palëve që kanë bërë shkelje të ligjit, si në zonën e Qendrës Historike të Prizrenit ashtu edhe në pjesët tjera të qytetit. Të njëjtat i kanë cilësuar të pazbatueshme dhe që e dëmtojnë interesin publik. Sipas Komunës, kjo Zyrë e MMPH ka intervenuar në disa raste kur Komuna ka tentuar të zbatojë ligjin dhe rendin në sektorin e ndërtimit, duke i mundësuar palëve që t'i vazhdojnë veprimtaritë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Rasti i fundit ka pas të bëjë me intervenim në qendrën tregtare, në ndërtim e sipër, në rrugën Tirana. Përkundër se në procesverbal, investitori ka deklaruar se do ta rrënojë pjesën e objektit, që është ndërtuar në hapësirën e paraparë për rrugë komunale, zyrtarët e MMPH i kanë dërguar një vendim Drejtorisë së Inspektoratit të Komunës, i cili e anulon vendimin ku pala ka pranuar vetë të bëjë rrënimin. Komuna ka konsideruar se mos konsultimi me të nga MMPH-ja para se të merret vendimi, bën që ai të jetë i pazbatueshëm dhe e dëmton interesin publik. Ky vendim, sipas komunikatës së Komunës është marrë "sa për t'i hedhur hi syve" opinionit, ngase nuk ka bazë ligjore që mundëson mosveprimin e zyrtarëve komunalë te rasti në fjalë.

Komuna ka akuzuar Zyrën ligjore të MMPH-së se në disa raste të fundit ka vepruar njëanshëm

kundrejt vendimeve të Komunës së Prizrenit, duke tentuar të amnistojë keqqeverisjen e shkaktuar në dhjetëvjetëshin e fundit dhe ka kërkuar që organet e hetuesisë të fillojnë hetimet ndaj Zyrës Ligjore në MMPH për ndërhyrje në vendimet e Komunës.

g) Transparenca e ultë për dokumentet e planifikimit hapësinor

Në anën tjetër transparenca e organeve komunale sa i përket njoftimit të publikut për dokumentet e planifikimit hapësinor që janë në përgjegjësi të nivelit lokal, për hartimin dhe zbatimin e tyre, është e ultë. Për më tepër ka krijuar telashe për ambientin jetësor të banorëve në pjesë të ndryshme të qytetit. Gjatë monitorimit EC ka hasur në raste kur Plani rregullues është adoptuar në tërësi për nevojat e bizneseve të ndërtimtarisë, duke mos i pas parasysh nevojat e banorëve përreth dhe duke mos i përfshirë fare në proces.

Krejt kjo situatë ka ndikuar negativisht edhe në zhvillimin e aktivizmit qytetar. Ndërkohë preokupimet urbanistike të qytetarëve të Prizrenit mbeten në nivele bazike, që kryesisht ndërlidhen me lirinë e lëvizjes, dëmtimin e trashëgimisë kulturore dhe mjedisin, të cilat do të duhej të adresoheshin deri më tani nga niveli lokal.

h) Vdekjet në vendin e punës, kryesisht në sektorin e ndërtimtarisë

Ndërkohë situata në sektorin e ndërtimit është tejet e pafavorshme për punëtorët e angazhuar aty, sa i përket sigurisë në punë. Incidentet e punëtorëve në vendin e punës rezultojnë me lëndime serioze trupore e deri te rastet me fatalitet. Mediat kanë raportuar se në vitin 2018, 22 punëtorë kanë humbur jetën në

vendin e punës, kryesisht në sektorin e ndërtimitarisë.¹⁸ Ky numër është më i lartë se në vitin 2017. Organizata ka provuar që t'i konfirmojë të dhënat nga Inspektorati i Punës dhe MPMS-ja, por nuk ka marrë përgjigje zyrtare.

V. Trashëgimia kulturore vuan mosunifikimin e veprimeve të institucioneve

Incidentet e rrënimit të ndërtesave të trashëgimisë kulturore kanë vazhduar. Institucionet e nivelit lokal dhe atij qendror nuk i kanë unifikuar veprimet ndërmjet vete për ndalimin e këtyre rasteve. Veprimi i organeve të sistemit të drejtësisë në këtë aspekt ka mbetur i ngadalshëm.

Task-forca e krijuar në vitin 2014 për t'u marrë me ndërtimet e paligjshme në Qendrën Historike të Prizrenit nuk ka qenë efikase. Në mandatin aktual të Qeverisë së Kosovës janë emëruar anëtarët e rinj të kësaj Task-Force, të cilët kanë mbajtur dy takime.¹⁹

Nevojiten ende më shumë përpjekje për të siguruar mbrojtjen dhe menaxhimin adekuat të trashëgimisë kulturore në të gjithë Kosovën.

MKRS në fillim të këtij viti ka funksionalizuar Inspektoratin e Trashëgimisë Kulturore. Ky

¹⁸ "101 punëdhënësve në sektorin e ndërtimitarisë u ndërpritet puna, s'ka kushte", koha.net, linku: <https://www.koha.net/arberi/129627/101-punedhenesve-ne-sektorin-e-ndertimtarise-u-nderpritet-puna-ska-kushte/>, qasur me 18 nëntor 2018.

¹⁹ Përgjigje përmes emailit nga Bajram Kadriu, Zyrtar i lartë për Komunikim, MMPH, 13 nëntor 2018

Inspektorat në nivel vendi ka paraqitur 6 kallëzime penale (5 në Prizren dhe 1 në Pejë).²⁰

Buxheti i MKRS-së për programin Ruajtja, mbrojtja dhe promovimi i TK ka shënuar rritje prej vitit 2016, në të gjitha kategoritë buxhetore, respektivisht në linjën e subvencioneve dhe atë të investimeve kapitale (Mbi 3 milionë në vitin 2016, afër 4.9 milionë euro në vitin 2017 dhe mbi 5.7 milionë euro në vitin 2018). Nga ky buxhet, mbështetet veprimtaria e institucioneve vartëse të trashëgimisë kulturore (Instituti i Kosovës për Mbrojtje të Monumenteve, Muzeu i Kosovës, Instituti Arkeologjik i Kosovës dhe 6 qendra rajonale për trashëgimi kulturore).²¹ MKRS ka investuar mjete financiare për intervenimet emergjente në ndërtesat e trashëgimisë kulturore të Prizrenit. Më 28 maj 2018, në Prizren, është nënshkruar Letra e Marrëveshjes për hartimin e projektit të "Revitalizimit dhe integritimit socio-ekonomik të komunitetit lokal në rrugën Marin Barleti" në Qendrën Historike të Prizrenit. Marrëveshja u nënshkrua nga ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit z. Kujtim Gashi, shefja e Zyres së BE-së në Kosovë znj. Nataliya Apostolova, kryetari i Komunës së Prizrenit z. Mytahir Haskuka, përfaqësuesja e Ambasadës Britanike znj. Chablise Stoner dhe drejtori ekzekutiv i EC Ma Ndryshe z. Edon Mullafetahu. Qëllimi kryesor i projektit është krijimi i një shembulli pozitiv të rigjenerimit urban që do të ndikojë në ruajtjen e karakterit historik të qytetit dhe ofrimi i kushteve optimale për ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe zhvillim të qëndrueshëm lokal.

²⁰ Përgjigje përmes emailit nga Samir Hoxha, këshilltar i ministrit të MKRS-së, 6 nëntor 2018

²¹ Po aty

Projekti përbëhet nga dy komponenta kryesore, ajo e konservimit dhe zhvillimit lokal.

MKRS ka vlerësuar se vitin 2018 e kanë përcjell disa dëmtime të aseteve të trashëgimisë kulturore si rezultat i mungesës së zbatimit të ligjit për TK dhe QHP nga Komuna e Prizrenit, duke përfshirë shumicën e drejtorive komunale. Drejtorja e Urbanizmit edhe pse bazuar në dispozitat e ligjit për QHP-në obligohet që të gjitha kërkesat për projekte leje urbanistike, ndërtimi, rrënimi apo ndryshimi të objekteve, për ndërrim të destinimit të tyre, zhvillim të aktiviteteve të përkohshme apo çfarëdo zhvillimi tjetër brenda Qendrës Historike të Prizrenit, t'i dorëzoj QRK-së Prizren dhe Këshillit për Trashëgimi Kulturorë, e njëjta e ka anashkaluar shumë herë këtë procedurë, me çka ka dëmtuar asetet e trashëgimisë kulturore në Qendrën Historike.

Po ashtu, sipas MKRS-së, Komuna e Prizrenit, duke i tejkalluar autorizimet ka ndërmarr veprime për ndërhyrje brenda QHP-së, duke rregulluar infrastrukturën pa marrë pëlqim nga organet kompetente të trashëgimisë kulturore.

MKRS ka mbështetur hartimin e Planit të Menaxhimit, që është hartuar nga përfaqësuesit e shoqërisë civile me përfshirje të gjerë të të gjitha palëve tjera të interesit, dhe ka paralajmëruar edhe përkrahjen për projektin e veçantë për rrugën Marin Barleti (në kuadër të Qendrës Historike). Por ka theksuar se miratimi dhe zbatimi i Planit të menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit në këto rrethana duket të jetë i vështirë.²²

²² Po aty

VI. Statistikat e organeve të sistemit të drejtësisë për ndërtimet pa leje dhe shkatërrimin e Trashëgimisë Kulturore në Prizren

Numri i lëndëve që trajtohen nga organet e sistemit të drejtësisë lidhur me ndërtimet pa leje dhe shkatërrimin e dëmtimin e trashëgimisë kulturore mbetet i vogël.

Statistikat e Prokurorisë Themelore në Prizren për periudhën janar-shtator 2018 për rastet që lidhen me ndërtime pa leje, tejkalimin e lejeve dhe rrënimin e dëmtimin e monumenteve të trashëgimisë kulturore në Qendrën Historike të Prizrenit, tregojnë për numër të vogël të aktakuzave ndaj të dyshuarve për këto vepra penale.

Sipas Prokurorisë, lëndë të bartura nga periudha paraprake janë 6 kallëzime me 6 persona, të pranuar në punë (janar-shtator 2018) 2 kallëzime me 5 persona që do të thotë se gjithsej lëndë në punë janë 8 kallëzime me 11 persona. Hetimet kanë filluar në 2 kallëzime me 2 persona, ndërkaq janë ngritur 3 aktakuza për 4 persona, derisa në punë mbeten 5 kallëzime me 7 persona.²³

Sipas raportimeve të mediave, Prokuroria Themelore në Prizren ka ngritur gjithsej 18 aktakuza për 31 persona, për periudhën kohore janar 2013 deri në shtator 2018, për dëmtimin e monumenteve të trashëgimisë kulturore në Qendrën Historike të Prizrenit.²⁴

²³ Përgjigje me email nga Zyra për Informim e Prokurorisë Themelore të Prizrenit, 9 nëntor 2018.

²⁴ "Shkatërruesit e trashëgimisë kulturore në Prizren si ndëshkon askush", kallxo.com, linku: <https://kallxo.com/gjnk/shkaterruesit-e-trashegimise-kulturore-ne-prizren-si-ndeshkon->

Gjykata Themelore e Prizrenit ka bërë të ditur se gjatë vitit 2018 (periudha kohore deri në fund të muajit tetor) sa i përket nenit 364 të Kodit Penal (Punimet e paautorizuara dhe përvetësimi i monumenteve kulturore) nuk ka asnjë lëndë në procedurë.

Ndërkaq sipas nenit 363 të Kodit Penal (Dëmtimi, shkatërrimi dhe nxjerrja e paautorizuar e monumenteve ose objekteve të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës), 1 lëndë ka qenë e bartur prej vitit paraprak, ndërsa deri në muajin tetor të vitit 2018 kanë arritur edhe 3 lëndë të tjera, ku gjithsej janë 4 lëndë. Prej tyre 1 lëndë është zgjidhur me kusht dhe 3 lëndë janë në proces.²⁵

Sipas raportimeve të mediave, në Gjykatën Themelore të Prizrenit gjatë vitit 2013 dhe 2014 nuk është trajtuar asnjë lëndë sa i përket dëmtimit të objekteve të trashëgimisë kulturore. Në vitin 2015, në punë kanë qenë dy lëndë, kurse në vitin 2016 janë bartur dy lëndë, është regjistruar një lëndë e re, asnjë lëndë nuk është zgjidhur dhe tri lëndë kanë mbetur për vitin e pasues 2017-të, të gjitha këto në lidhje me nenin 363 të Kodit Penal. Në vitin 2017, janë bartur tri lëndë, prej tyre dy janë zgjidhur me gjobë dhe një lëndë ka mbetur e pa kryer.²⁶

[askush/?fbclid=IwAR2x-onynugZujQW7xoMWNyuy06F8x8d66Q1_RRyRneyuoxKC8KUWkr_HCO](https://askush.com/?fbclid=IwAR2x-onynugZujQW7xoMWNyuy06F8x8d66Q1_RRyRneyuoxKC8KUWkr_HCO), qasur me 20 nëntor 2018.

²⁵ Përgjigje me email nga Zyra për Informim e Gjykatës Themelore të Prizrenit, 30 tetor 2018

²⁶ "Shkatërruesit e trashëgimisë kulturore në Prizren si ndëshkon askush", kallxo.com, linku: https://kallxo.com/gjnk/shkaterruesit-e-trashegimise-kulturore-ne-prizren-si-ndeshkon-askush/?fbclid=IwAR2x-onynugZujQW7xoMWNyuy06F8x8d66Q1_RRyRneyuoxKC8KUWkr_HCO, qasur me 20 nëntor 2018.

Këto statistika tregojnë se edhe zbatimin e ultë të dispozitave sanksionuese. Kjo qasje e institucioneve ka krijuar dhe zhvilluar kulturën e pandëshkueshmërisë në raport me trashëgiminë kulturore në Qendrën Historike të Prizrenit.

VII. Sfidat për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore në Kosovë

Krahas Trashëgimisë Kulturore, në Kosovë ka mjaft sfida edhe për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore. Zonat e mbrojtura përballen me rrezikun e degradimit, ku ndërtimet e paligjshme duhet të parandalohen.

Sipas MMPH-së, sfidat aktuale për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore në Kosovë janë: Mungesa e Planit Hapësinor dhe Planit Menaxhues për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"; Mungesa e planeve rregulluese për zonat e treta në Parqet Kombëtare; Mungesa e stafit profesional për mbrojtjen e natyrës; Mungesa e organeve menaxhuese për (disa) zona të mbrojtura; Ndërtimet, gjuetia dhe prerjet ilegale në zonat e mbrojtura; Mungesa e mjeteve financiare për mbrojtjen e natyrës, etj.²⁷

VIII. Rekomandimet

- Autoritetet e nivelit qendror dhe atij lokal të zbatojnë në mënyrë efikase legjislacionin në mjedis, planifikim, ndërtimtari dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;
- Kodi Unik i Ndërtimit të aprovet në afatin sa më të shkurtër kohor;
- Të rritet pjesëmarrja e qytetarëve në planifikim dhe vendimmarrje, në mjedis,

²⁷ Përgjigje përmes emailit nga Bajram Kadriu, Zyrtar i lartë për Komunikim, MMPH, 13 nëntor 2018

planifikim, ndërtimtari dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;

- Të harmonizohen kompetencat e nivelit qendror dhe lokal në mjedis, planifikim, ndërtimtari dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;

- Shkeljet ligjore që kanë të bëjnë me lejet ndërtimore, por edhe të rrënit të ndërtesave të trashëgimisë kulturore të adresohen nga gjyqësori në mënyrë më efektive;

- Task-Forca për Qendrën Historike të Prizrenit duhet ta dinamizojë angazhimin e vet dhe të jetë transparente para publikut;

- Miratimi dhe zbatimi i planeve të menaxhimit për Qendrat Historike të Kosovës

- Të shtohen masat për rritjen e sigurisë në punë, sidomos në sektorin e ndërtimitarisë;

- Të adresohen sfidat ekzistuese për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore dhe të parandalohen ndërtimet pa leje në zonat e mbrojtura.



Ky studim u hartua nga EC Ma Ndryshe, me mbështetje të Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS).